



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr. 783/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Zyhdi Haziri dhe Adnan Konushevci anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Arjeta Sylja, duke vendosur përkitazi me apelin e Bashkim Fazliu, nga radhët e subjektit politik NISMA për Kosovën, me seli në Prishtinë, dega në Ferizaj, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si i pabazuar apeli i parashtruar nga Bashkim Fazliu, nga radhët e subjektit politik NISMA për Kosovën, me seli në Prishtinë, dega në Ferizaj, me shenjen ZL.Anr.783/2017, të datës 09.11.2017, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar me postë apelin ZL.Anr.783/2017 me datën 09.11.2017, nga Bashkim Fazliu, nga radhët e subjektit politik NISMA për Kosovën, me seli në Prishtinë, dega në Ferizaj, me të cilën ka pretenduar se ka mospërputhje të rezultatit përfundimtar me rezultatit preliminar, ku pretendon se në rezultatit preliminar kanë 670 vota, ndërsa në rezultatet përfundimtare kanë 486 vota, pra del që ka dallim në rezultat prej 184 vota.

PZAP-i, pas shqyrtimit të bazueshmërisë së pretendimeve ankimore si dhe shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Paneli vlerësoi se pretendimet në apel nuk paraqesin bazë ligjore për miratimin e apelit, kj për faktin se mos përputhje e votave të subjektit politik NISMA për Kosovën, me seli në Prishtinë, dega në Ferizaj, në mes rezultatit përfundimtar dhe preliminar nuk mund të cilësohen si shkelje të ligjit, për faktin se rezultati preliminar është rezultat i ndryshueshëm dhe KQZ në këto zgjedhje nuk ka shpallur rezultat preliminar. Rezultatet e publikuara në faqen e KQZ-së janë rezultate të dala drejtpërdrejtë nga futja e të dhënave në QNR të cilat rezultate nuk janë përfundimtare, ndërsa rezultati përfundimtar për të cilën apeluesi i referohet në apel është një përmbledhje e numrit të përgjithshëm të votave që pretendohet se i ka. Apeluesi në apel nuk ka specifikuar asnjë Qendër të Votimit ku pretendon se ka pasur parregullsi në mungesë të votave, ndërsa pretendimet e tij lidhur me keqpërdorimin eventual të votave nuk e ka mbështetur me asnjë provë bindëse.

Prandaj, Paneli konsideron se apeli i apeluesit nuk ka bazë ligjore pasi që është i përgjithësuar dhe i paargumentuar me fakte konkrete ku konsistojnë shkeljet e pretenduara ligjore dhe apeluesi i tillë, sipas vlerësimit të Panelit nuk i plotëson kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitën ligjore të nenit 117.2 i cili përcakton se: *“Gjatë vendosjes për një ankesë ose apel KZAP-i shqyrton dhe heton të gjitha dëshmitë relevante dhe mundëson seancë dëgjimore në rast se e konsideron këtë të nevojshme”*. Ndërsa, neni 117.3 përcakton se: *“Vendosja për apelet dhe ankesat nga PZAP-i mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse.*

Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmime konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në apele, duke u bazuar në nenin 10.7 pika c) e Rregullës 02/2015 Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, konstaton se apeli në fjalë është i pa argumentuar dhe si të tillë i pabazuar andaj e refuzoj.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa

ZL.Anr.783/2017 më datën 12.11.2017

Kryesuese e Panelit / Prishtina
Gyltene Sylejmani



Udhëzim Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*